



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 802/2022

Datë: 14 korrik 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 19 paragrafët 3 dhe të Rregullores Nr. 06/2019 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 14 korrik 2022, mori këtë:

VENDIM

- I. Z. Enis Gashi, prokuror në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, caktohet ushtrues i detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë.
- II. Z. Enis Gashi do të ushtrojë këtë pozitë nga data 15 korrik 2022 deri në një vendim të ri të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- III. Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, z. Enis Gashi, është i obliguar të ushtrojë kompetencat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- IV. Z. Gashi ka të drejtë në beneficionet që dalin nga ushtrimi i funksionit të ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë.
- V. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në ueb portalin e sistemit prokurorial të Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Me datë 14 korrik 2022, Këshilli Prokurorial i Kosovës (Këshilli) ka pranuar kërkesën nga Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit z. Besim Kelmendi në cilësinë e autoritetit kompetent për inicimin e procedurës disiplinore ndaj Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë z. Ramiz Buzhala, me arsyetimin se i njëjti me veprimet të cilat i ka ndër marrë në publikim të pyetjeve për procesin e rekrutimit të bashkëpunëtorëve profesional në Konkursin Publik për Prokuroritë Themelore në

Gjakovë, Pejë dhe Prizren me të cilat veprime i njëjti dyshohet se është përfshirë në sjellje të cilat dëmtojnë reputacionin e Prokurorit të Shtetit ose që mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e Prokurorit të Shtetit.

Pas fillimit të procedurës disiplinore, Këshilli bazuar në legjislacionin në fuqi ka marr vendim për suspendimin e Kryeprokurorit Buzhala deri në përfundim të procedurës disiplinore.

Andaj, pas suspendimit të Kryeprokurorit Buzhala, Këshilli me qëllim të sigurimit të funksionalitetit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Ti dërgohet:

- Z. Enis Gashi;
- ZKPSH;
- Sekretariatit të KPK-së;
- NJSHPP;
- Arkivit të KPK-së.